

Nr. Prot. 032/B/17

Nr. i Regjistrimit: 31

RREGULLORE TEKNIKE PER RADIO-PAJISJET

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo rregullore teknike (*tutje referuar si – Rregullore*) është përgatitur në bazë të dispozitave të neneit 1, neni 9 paragrafi 3.8, neni 10 paragrafit 4 dhe neni 94, të Ligjit Nr 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe nga Direktiva 2014/53/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të radio-pajisjeve.

Neni 2 Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kornize rregullative për vënien në dispozicion në treg dhe vënien në shërbim dhe përdorim, vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut të radio-pajisjeve në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Fushëveprimi

1. Rregullorja do të zbatohet për të gjitha radio-pajisjet me përjashtim atyre të listuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe dispozitat e tij janë të detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomik, dhe subjektet tjera të përmendura në Rregullore.
2. Kjo rregullohet nuk do të zbatohet për:
 - 2.1. Radio-pajisjet e përdorura nga radio amatorët në kuadër të kuptimit të neni 1, përkufizimi 56, të radio-rregulloreve të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), përveç nëse pajisja është vënë në dispozicion në treg. Pajisjet në vijim do të konsiderohen se nuk janë vënë në dispozicion në treg:

- a) pajimet e radios për montim dhe përdorim nga radio amatorët;
 - b) radio-pajisjet e modifikuara nga dhe për përdorim të radio amatorëve;
 - c) pajisjet e ndërtuara nga radio amatorët individual për qëllime eksperimentale dhe shkencore që lidhen me radion amatore.
- 2.2. Pajisjet të cilat përdoren ose janë të destinuara për përdorim në të gjitha anijet për të cilat aplikohet Konventa Ndërkombëtare e vitit 1974 "Për shpëtimin e jetës në det" (SOLAS).
 - 2.3. Produktet, pjesët dhe pajisjet ajrore të përkufizuara në Shtojcën I.
 - 2.4. Pajimet (veglat e punës) të ndërtuara posaçërisht për profesionistët që do të përdoren vetëm në objekte hulumtimi dhe zhvillimi për qëllime të tilla.
 - 2.5. Radio-pajisjet të cilat përdoren ekskluzivisht për veprimtari që ndërlidhen me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë e shtetit, duke përfshirë edhe mirëqenien ekonomike të shtetit në rastin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë shtetërore, dhe aktivitetet e shtetit në fushën e të drejtës penale.

Neni 4 **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e Rregullores do të zbatohen përkufizimet në vijim:
 - 1.1 **radio-pajisje** nënkupton një produkt elektrik ose elektronik, i cili qëllimisht emeton dhe/ose pranon radio valë për qëllime të radio komunikimit dhe/ose radio-përcaktimit, ose një produkt elektrik ose elektronik, i cili duhet të plotësohet me pajisje shtese, siç është antena, në mënyrë që qëllimisht të emetoj dhe/ose të pranoj radio valë për qëllim të radio komunikimit dhe/ose radio-përcaktimit
 - 1.2 **Radio komunikimi** nënkupton komunikimin përmes radio valëve ;
 - 1.3 **radio-përcaktimi** nënkupton përcaktimin e pozitës, shpejtësisë dhe/ose karakteristikave tjera të një objekti, apo marrjen e informacionit në lidhje me këto parametra, nga vetit e përhapjes së radio valëve;
 - 1.4 **radio valët** nënkuptojnë valët elektromagnetike të frekuencës më të ulët se 3000 GHz, të emetuara në hapësirë pa drejtim artificial;
 - 1.5 **radio ndërfaqja** nënkupton specifikacionin e shfrytëzimit të rregulluar të spektrit radio-frekuencor;
 - 1.6 **klasa e radio-pajisjeve** nënkupton një klasë e cila identifikon kategori të veçanta të radio-pajisjeve të cilat, sipas rregullores, konsiderohen të ngjashme dhe ato ndërfaqe të radios për të cilën është dizajnuar radio-pajisja;
 - 1.7 **pengesa elektromagnetike** nënkupton çdo dukuri elektromagnetike e cila mund të degradojë performancën e pajisjeve; një pengese elektromagnetike mund të jetë

zhurma elektromagnetike, një sinjal i padëshiruar ose një ndryshim në vetë mediumin emetues;

- 1.8 **vënia në dispozicion në treg** nënkupton çdo furnizim me radio-pajisje për distribuim, konsum ose përdorim në tregun e Republikës së Kosovës në rrjedhën e një veprimtarie tregtare, qoftë në këmbim të pagesës ose pa pagesë;
- 1.9 **vendosja në treg** nënkupton vendosjen e parë në dispozicion të radio-pajisjeve në tregun e Republikës së Kosovës;
- 1.10 **vënja në shërbim** nënkupton përdorimin e parë të radio-pajisjeve në Republikën e Kosovës, nga përdoruesi fundor;
- 1.11 **prodhuesi** nënkupton çdo person fizik ose juridik i cili prodhon radio-pajisje, ka dizajnuar ose prodhuar radio-pajisje, dhe i vë në treg pajisjet nën emrin ose markën e tij tregtare;
- 1.12 **Përfaqësues i autorizuar** nënkupton çdo person fizik ose juridik i themeluar në kuadër ligjeve të Republikës së Kosovës që ka marrë një mandat me shkrim nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyrat e përcaktuara;
- 1.13 **importuesi** nënkupton çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës, i cili i vendos radio-pajisjet nga vendet tjera në tregun e Republikës së Kosovës;
- 1.14 **distributori** nënkupton çdo person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, që vë në dispozicion në treg radio-pajisjet;
- 1.15 **operatori ekonomik** nënkupton prodhuesin, përfaqësuesin e autorizuar, importuesin dhe distributorin;
- 1.16 **specifikacionet teknike** nënkupton një dokument që përshkruan kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga radio-pajisjet;
- 1.17 **standardët e harmonizuara evropiane** nënkupton një standard Evropian të miratuar në bazë të një kërkesë të bërë nga Komisioni Evropian për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian;
- 1.18 **vlerësimi i konformitetit** nënkupton procesin që demonstroi nëse janë përmbushur kërkesat themelore të Rregullores lidhur me radio-pajisjet;
- 1.19 **trupi për vlerësimin e konformitetit** nënkupton një trup që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit të radio-pajisjeve;
- 1.20 **kthimi** nënkupton çdo masë që synon realizimin e kthimit të radio-pajisjeve që tashmë janë vënë në dispozicion tek përdoruesi fundor;
- 1.21 **tërheqje** nënkupton çdo masë që synon parandalimin e radio-pajisjeve në zinxhirin e furnizimit nga vërja në dispozicion në treg;

- 1.22 **legjislacioni harmonizues i Bashkimit Evropian** nënkupton çdo legjislacion i Bashkimit Evropian që harmonizon kushtet për tregtimin e produkteve;
- 1.23 **shënjimi i konformitetit** nënkupton shenjen CE përmes së cilit prodhuesi tregon se radio-pajisja është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin e harmonizuar të Bashkimit Evropian që përcakton vendosjen e tij, ose do të thotë shënjimi i konformitetit i përcaktuar në Rregulloren nr. 06/2013 mbi Shënjimin e Konformitetit dhe përmes së cilit prodhuesi tregon se radio-pajisja është në konformitet me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara me akte të veçanta ligjore të Republikës së Kosovës, të cilat dispozita kërkojnë shënjimin me shenjen e konformitetit.
- 1.24 **standardi i Kosovës** nënkupton një standard në dispozicion të publikut dhe të miratuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit;
- 1.25 **standardi i harmonizuar i Kosovës** nënkupton Standardin e harmonizuar Evropian i miratuar si standard i Kosovës i miratuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit;
- 1.26 **trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit** nënkupton një trup për vlerësimin e konformitetit që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit të radio-pajisjes në bazë të vendimit për autorizim i cili është miratuar nga ARKEP.
2. Përkufizimet tjera kanë kuptimin ashtu siç janë dhënë në Ligj.

Neni 5

Kërkesat esenciale të radio-pajisjeve

1. Radio-pajisjet duhet të ndërtohen në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e personave dhe të kafshëve shtëpiake dhe mbrojtjen e pronës, duke përfshirë objektivat në lidhje me kërkesat e sigurisë të përcaktuara në Rregulloren për pajisjet elektrike të dizajnuara për përdorim brenda kufijëve të caktuar të tensionit (MTI nr. 05/2016) por pa aplikuar kufizim të tensionit elektrik;
2. Radio-pajisjet duhet të ndërtohen në mënyrë që të sigurohet një nivel adekuat i pajtueshmërisë elektromagnetike siç është përcaktuar në Rregulloren për pajtueshmërinë elektromagnetike të MTI Direktiva 2014/30/EU;
3. Radio-pajisjet duhet të ndërtohen në atë mënyrë që të përdoren në mënyrë efektive dhe të mbështesin përdorimin efikas të spektrit radio frekuencor për të shmangur interfrenat e dëmshme.
4. Përveç pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3 të këtij neni, radio-pajisjet e listuara më poshtë do të ndërtohen në atë mënyrë që të jenë në pajtueshmëri me kërkesat thelbësore të mëposhtme:
 - 4.1. radio-pajisja që operon në brezet frekuencore, të përcaktuara nga marrëveshja në lidhje me shërbimin radiotelefonik në kanale ujore tokësorë do të zbaton sistemin automatik për identifikimin e transmetuesve (ATIS) të përcaktuara në Shtojcën B të ETS 600698. Radio-pajisjet e komunikimit në kategoritë e shërbimit "anije-me-anije",

"anije-me-autoritete e portit" dhe "për komunikim të brendshëm", të përcaktuara nga marrëveshja në lidhje me shërbimin radiotelefonik në kanale ujore tokësore nuk do të jetë në gjendje të transmetojë në fuqi të transmetuesit më të lartë se 1 vat.

- 4.2. radio-pajisja që operon në 457 kHz dhe ka për qëllim të gjej njerëzit e përmbysur nga bora pas një orteke (këtu e tutje –sinjalizues i ortekut) duhet të dizajnohet në mënyrë që të jetë në gjendje të ndërveproj me sinjalizues të rinj si dhe me bazën e instaluar të sinjalizuesve, i cili është miratuar sipas rregulloreve kombëtare të aprovuara të bazuara në ETS 300 718. Sinjalizuesit e ortekut do të ndërtohen në mënyrë që ato të funksionojnë në mënyrë të besueshme, pasi të ekspozohen ndaj një orteke dhe do të vazhdojnë të funksionojnë, pasi të zhyten në borë, pas një periudhë më të gjatë të ortekut.
- 4.3. radio-pajisja e cila është e destinuar për përdorim në të gjitha anijet tek të cilat nuk aplikohet Konventa Ndërkombëtare e vitit 1974 për Sigurinë e Jetës në Det (SOLAS) (këtu e tutje referuar si anije jo-SOLAS), dhe të cilat kanë për qëllim të marrin pjesë në Sistemin Global Detar të Shpëtimit dhe Sigurisë (GMDSS), siç përcaktohet në Kapitullin IV të konventës SOLAS që operon në njërin prej shërbimeve në vijim: shërbimin mobil detar, siç përcaktohet në nenin 1.28 të Radio Rregulloreve të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), shërbimin mobil satelitor detar, siç përcaktohet në nenin 1.29 të Radio Rregullores së ITU-së, duhet të hartohen për të siguruar funksionimin e duhur në ekspozimin në një mjedis detar, të përmbushin të gjitha kërkesat operationale të GMDSS të zbatueshme për anijet jo-SOLAS, në përputhje me dispozitat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare Detare, dhe të ofrojnë komunikim të qartë dhe të fuqishëm me një shkallë të lartë të besueshmërisë së lidhjeve analoge ose digjitale të komunikimit.
- 4.4. radio-pajisja e cila operon në shërbimin mobil detar, siç përcaktohet në nenin 1.28 të Radio Rregulloreve të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), ose në shërbimin mobil detar satelitor siç përcaktohet në nenin 1.29 të Radio Rregulloreve të ITU-së, duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që të sigurojnë se ato funksionojnë si duhet në mjedisin e synuar, kur përdoret në anije jo-SOLAS dhe në stacione tokësore dhe do të përmbushin të gjitha kërkesat e duhura operative të Sistemit të Identifikimit Automatik (AIS).
- 4.5. sinjalizuesit e vendndodhjes të synuar për të operuar në 406 MHz me sistemin Cospas-Sarsat duhet të jenë të dizajnuar për të siguruar funksionimin e duhur në përputhje me kërkesat e pranuar operative nën ekspozimin ndaj mjedisit në të cilin mund të përdoren. Në kushte rreziku ata do të ofrojnë komunikim të qartë dhe të fuqishëm me një shkallë të lartë të besueshmërisë duke përmbushur të gjitha kërkesat e sistemit Cospas-Sarsat.
- 4.6. Duke u bazuar në legjislacionin e harmonizuar të BE-së, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje – ARKEP*) ka fuqinë të nxjerr vendim për kërkesat thelbësore për caktimin e disa kategorive ose klasave të radio pajisjeve si në vijim:

- a) radio-pajisjet ndërveprojnë me pajisje shtese, në veçanti me mbushësit e zakonshëm;
- b) radio-pajisjet ndërveprojnë nëpërmjet rrjeteve me pajisje tjera radio;
- c) radio-pajisjet mund të lidhen me ndërfaqet e llojit të duhur në të gjithë Bashkimin Evropian;
- d) radio-pajisjet nuk dëmtojnë rrjetin apo funksionimin e tij, dhe as nuk keqpërdorin burimet e rrjetit, duke shkaktuar kështu një degradim të papranueshëm të shërbimit;
- e) radio-pajisja përfshin masa mbrojtëse për të siguruar që të dhënat personale dhe privatësia e përdoruesit dhe e abonuesit janë të mbrojtura;
- f) radio-pajisja mbështet karakteristika të caktuara që siguronë mbrojtje nga mashtrimi;
- g) radio-pajisja mbështet karakteristika të caktuara që siguronë qasje në shërbimet e emergjencës;
- h) radio-pajisja mbështet karakteristika të caktuara në mënyrë që të lehtësojë përdorimin e saj nga përdoruesit me aftësi të kufizuara;
- i) radio-pajisja mbështet karakteristika të caktuara në mënyrë që të sigurojë se softueri mund të vendoset në radio-pajisje vetëm kur është demonstruar pajtueshmëria e kombinimit të radio-pajisjes dhe softuerit.

Neni 6

Vëna në dispozicion në treg dhe vënia në shërbim dhe përdorimi i radio-pajisjeve

1. Radio-pajisja mund të vihet në dispozicion në treg vetëm nëse ajo është në pajtueshmëri me Rregulloren.
2. Radio-pajisja do të vihet në shërbim dhe përdoret në qoftë se është në pajtueshmëri me Rregulloren, kur instalohet, mirëmbahet dhe përdoret siç duhet për qëllimin e synuar.
3. ARKEP ka te drejtë të paraqesë kërkesa shtesë për vendosjen në treg dhe vënien në shërbim dhe/ose përdorim të radio-pajisjeve për arsye që lidhen me përdorimin efektiv dhe efikas të spektrit radio frekuncor, për shmangien e interfrecave të dëmshme, për shmangien e pengesave elektromagnetike apo për shëndetin publik.
4. Radio-pajisja e cila nuk është në pajtueshmëri me Rregulloren mund të shfaqet në panairë, ekspozita dhe ngjarje të ngjashme. Në raste të tilla duhet të vihet një shenjë e dukshme që në mënyrë të qartë tregon se radio-pajisjet e tilla nuk mund të vihen në dispozicion në treg apo vihen në shërbim deri sa të vije në pajtueshmëri me këtë rregullore. Demonstrimi (duke e nderur) radio-pajisjen mund të ndodhë vetëm kur janë marrë masat e duhura për të shmangur interfrecat e dëmshme, pengesat elektromagnetike dhe rreziku për shëndetin

ose sigurinë e personave ose të kafshëve shtëpiake ose të pronës. Këto masa do të dakordohen me ARKEP në formë të shkruar, 5 ditë pune para demonstrimit të tillë.

KAPITULLI II OBLIGIMET E OPERATORËVE EKONOMIK

Neni 7 Obligimet e prodhuesve

1. Gjatë vendosjes së radio-pajisjeve në treg, prodhuesit do të sigurojnë që pajisjet janë dizajnuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5.
2. Prodhuesit duhet të sigurojnë që radio-pajisja duhet të ndërtohen në mënyrë që të mund të operojn në Republikën e Kosovës në përputhje me kërkesat e aplikueshme për përdorimin e spektrit radio frekuencor.
3. Prodhuesit duhet të hartojnë dokumentacionin teknik të referuar në nenin 18 dhe të kryejnë procedurat përkatëse për vlerësimin e konformitetit referuar në nenin 14 ose ta kenë të kryeratë. Aty ku është demonstruar pajtueshmëria e radio-pajisjeve me kërkesat e zbatueshme nga ajo procedure e vlerësimit të konformitetit, prodhuesit duhet të hartojnë deklaratën e konformitetit dhe të vendosin shenjen e konformitetit.
4. Prodhuesit do të mbajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e konformitetit për 10 vjet pasi radio-pajisja të vendoset në treg.
5. Prodhuesit do të sigurohen që procedurat janë të vendosura që prodhimi në seri të mbetet në përputhje me Rregulloren. Ndryshimet në dizajnin ose karakteristikat e radio-pajisjeve dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara evropiane ose në specifikimet tjera teknike në reference të të cilave konformiteti i radio-pajisjes deklarohet, duhet të merret parasysh në mënyrë adekuate.. Kur vleresohen rreziqe te paraqitura nga radio pajisjet, në mënyrë që të mbrohet shëndeti dhe siguria e perdoruesve fundor, prodhuesit duhet te kryejn nje testim moster te radio pajisjes e vene ne dispozicion ne treg, hetojnë, dhe nëse është e nevojshme, të mbajnë një regjister të ankesave, të radio-pajisjeve që nuk janë në konformitet dhe të atyre që janë kthyer dhe duhet të mbaj distributorët të informuar për çdo monitorim të tillë.
6. Prodhuesit do të sigurojnë që radio-pajisja e cila është vendosur në treg të mbart llojin, grupin ose numrin serik ose një element tjetër që mundëson identifikimin e tij, ose kur madhësia apo natyra e radio-pajisjeve nuk e lejon këtë, informacioni i kërkuar të jepet në paketim, ose në dokumentin që shoqëron radio-pajisjen.
7. Prodhuesit duhet të shënojnë në radio-pajisjet, emrin e tyre, emrin e regjistruar tregtare ose markën e regjistruar tregtare dhe adresën postare në të cilën ata mund të kontaktohen, ose në rast kur madhësia apo natyra e radio-pajisjeve nuk e lejon këtë, në paketimin e tij, ose në një dokument përcjellës të radio-pajisjes. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme në të cilën prodhuesi mund të kontaktohet. Detajet e kontaktit duhet të jenë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

8. Prodhuesit do të sigurojnë që radio-pajisjet të shoqërohen me udhëzime dhe informacionet e sigurisë duhet të jenë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Udhëzimet duhet të përfshijnë informacionet e kërkuara për përdorimin e radio-pajisjeve në përputhje me përdorimin e synuar. Informacionet e tilla do të përfshijnë, kur është e zbatueshme, një përshkrim të pajisjeve shtese dhe komponentëve, duke përfshirë softuerin, i cili i mundësonë radio-pajisjen të funksionoj siç duhet. Udhëzimet dhe informacionet e tilla të sigurisë, si dhe çdo etiketim, duhet të jetë i qarte, dhe i kuptueshëm. Informacioni i mëposhtëm duhet gjithashtu të përfshihet në rastin e radio-pajisjeve që emetojnë radio valë:
 - a) brezi(-et) frekuencore në të cilin operon radio-pajisja;
 - b) fuqia maksimale e trasmetuar radio-frekuencore në brezin(-et) frekuencor në të cilin operon radio-pajisja.
9. Prodhuesit do të sigurojnë që çdo artikull i radio-pajisjeve është shoqëruar me një kopje të deklaratës së konformitetit ose me një deklaratë të thjeshtuar të konformitetit. Kur ofrohet një deklaratë e thjeshtuar e konformitetit, ajo duhet të përmbajë adresën e saktë në internet, ku mund të merret teksti i plotë i deklaratës së konformitetit.
10. Në rastet e kufizimeve në vënien në shërbim ose të kërkesave për autorizimin e përdorimit, informacioni në lidhje me kufizimet dhe kërkesat e tilla do të kompletohet në udhëzimet që shoqërojnë radio-pajisjen.
11. Prodhuesit të cilët e konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar se radio-pajisja të cilën e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me rregulloren, do të marrin menjëherë masat e nevojshme korrigjuese për të sjellë radio-pajisjen në konformitet, ta tërheqin apo kthejnë atë, nëse është e mundur. Për më tepër, aty ku radio-pajisjet paraqesin rrezik, prodhuesit do të informojnë menjëherë ARKEP për këtë qëllim, duke dhënë detaje, në mënyrë të veçantë, me mos-pajtueshmërinë, me masat korrigjuese të ndërmarra dhe rezultatet e tyre.
12. Prodhuesit duhet, pas një kërkesë të arsyetuar nga ARKEP, brenda afatit të përcaktuar nga ARKEP-i të ofrojnë të gjitha informatat dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër apo formë elektronike për të demonstruar konformitetin e radio-pajisjes me Rregulloren, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës ose në gjuhë të pranueshme për ARKEP-in. Ata do të bashkëpunojnë me ARKEP, sipas kërkesës së tij, mbi çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga radio-pajisjet të cilat ata i kanë vendosur në treg.

Neni 8

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Prodhuesi mund të emërojë një përfaqësues të autorizuar në form të shkruar.
2. Obligimet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 7 dhe obligimi për të hartuar dokumentacionin teknik të përcaktuar në pikën 3 të nenit 7 nuk do të jetë pjesë e mandatit të përfaqësuesit të autorizuar.
3. Përfaqësuesi i autorizuar do të kryej detyrat e përcaktuara në mandatin e marrë nga prodhuesi. Mandati do të lejojë përfaqësuesit e autorizuar të bëjnë të paktën veprimet në vijim:

- 3.1 mbajë deklaratën e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të ARKEP për 10 vjet pasi radio-pajisja është vendosur në treg;
- 3.2 pas kërkesës së arsyetuar nga ARKEP-i, t'i ofroj ARKEP-it të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar konformitetin e radio-pajisjes;
- 3.3 bashkëpunoj me ARKEP-in, me kërkesë të tij, mbi çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga radio-pajisjet të mbuluara nga mandati i përfaqësuesit të autorizuar.

Neni 9

Obligimet e importuesit

1. Importuesit do të vendosin vetëm radio-pajisje kompatible në treg.
2. Para vendosjes së radio-pajisjes në treg, importuesit do të sigurohen se është realizuar procedura e duhur për vlerësimin e konformitetit të referuar në nenin 14 nga ana e prodhuesit dhe se radio-pajisja është ndërtuar në mënyrë që ajo mund të operohet në Republikën e Kosovës pa cenuar kërkesat e aplikueshme mbi përdorimin e spektrit radio frekuencor. Ata duhet të sigurojnë që prodhuesi ka hartuar dokumentacionin teknik, se radio-pajisjet bartin shenjen e konformitetit dhe shoqërohet me informacionin dhe dokumentet e referuara në paragrafët 8, 9 dhe 10 të nenit 7, dhe se prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në paragrafët 6 dhe 7 të nenit 7. Kur një importues konsideron ose ka arsye për të besuar se radio-pajisja nuk është në konformitet me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5, ai nuk do të vendos radio-pajisjen në treg deri sa ajo të kthehet në konformitet. Për më tepër, aty ku radio-pajisja paraqet rrezik, importuesi duhet të informoj prodhuesin dhe ARKEP-in për këtë çështje.
3. Importuesit duhet të shënojnë në radio-pajisje emrin e tyre, emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare dhe adresën postare në të cilën ata mund të kontaktohet ose, kur kjo nuk është e mundur, në paketimin e tij ose në një dokument që shoqëron radio-pajisjen. Kjo përfshin rastet kur madhësia e radio-pajisjeve nuk e lejojnë këtë, ose kur importuesit do të duhet të hapin paketimin në mënyrë që të tregojnë emrin dhe adresën e tyre në radio-pajisje. Detajet e kontaktit duhet të jenë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Importuesit do të sigurojnë që radio-pajisja të shoqërohet me udhëzimet dhe informacionin e sigurisë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Importuesit do të sigurojnë që, përderisa radio-pajisja është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e ruajtjes ose transportit të pajisjes nuk rrezikojnë pajtueshmërinë e tij me kërkesat themelore të përcaktuara në nenin 5.
6. Kur vlerësohen rreziqe të paraqitura nga radio pajisjet në mënyrë që të mbrohet shëndeti dhe siguria e përdoruesve fundor, importuesit duhet të kryejnë një testim moster të radio pajisjes e vënë në dispozicion në treg, hetojnë, dhe nëse është e nevojshme, të mbajnë një

regjister të ankesave, të radio-pajisjeve që nuk janë në konformitet dhe të atyre që janë kthyer dhe duhet të mbaj distributorët të informuar për çdo monitorim të tillë.

7. Kur Importuesit konsiderojnë ose kanë arsye për të besuar se radio-pajisja të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me rregulloren, do të marrë menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për të sjellë radio-pajisjen në konformitet, të tërheq apo të kthej atë, nëse është emundur. Për më tepër, aty ku radio-pajisja paraqet rrezik, importuesit do të informoj menjëherë ARKEP për këtë qëllim, duke dhënë detaje, në mënyrë të veçantë, për mos-pajtueshmërinë dhe për masat korrigjuese të ndërmarra.
8. Importuesit duhet, për 10 vjet pasi që radio-pajisja është vendosur në treg, të mbaj një kopje të deklaratës së BE-së për konformitetin në dispozicion të ARKEP dhe të siguroj se dokumentacioni teknik mund të vihet në dispozicion të ARKEP, sipas kërkesës.
9. Importuesit duhet, pas një kërkesë të arsyetuar nga ARKEP, brenda afatit të përcaktuar nga ARKEP-i të ofrojnë të gjitha informatat dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër apo formë elektronike për të demonstruar konformitetin e radio-pajisjes në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës ose në gjuhën angleze. Ata duhet të bashkëpunojnë me ARKEP, me kërkesë të tij, mbi çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga radio-pajisjet të cilat ata i kanë vendosur në treg.

Neni 10 **Obligimet e distributorëve**

1. Kur distributorët vënë radio-pajisjen në dispozicion në treg, ata duhet të veprojnë me kujdesin e duhur në lidhje me kërkesat e Rregullores.
2. Para vendosjes së radio-pajisjes në treg, distributorët do të verifikojnë që radio-pajisja që bart shënjinin e konformitetit shoqërohet me dokumentet e kërkuara nga Rregullorja dhe udhëzimet si dhe në aspektet e sigurisë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe se prodhuesi dhe importuesi janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2, 6, 7, 8, 9, 10 të nenit 7 dhe respektivisht paragrafit 3 të nenit 9. Kur një distributor konsideron ose ka arsye për të besuar se radio-pajisja nuk është në konformitet me kërkesat themelore të përcaktuara në nenin 5, ai nuk do të vë radio-pajisjen në dispozicion në treg, derisa të sjellë në konformitet. Për më tepër, atëherë kur radio-pajisja paraqet rrezik, distributori duhet të informoj prodhuesin ose importuesin për këtë qëllim, si dhe ARKEP-in.
3. Distributorët do të sigurojnë që, përderisa radio-pajisja është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e ruajtjes ose transportit të pajisjes nuk rrezikojnë pajtueshmërinë e tij me kërkesat themelore të përcaktuara në nenin 5.
4. Kur Distributorët konsiderojnë ose kanë arsye për të besuar se radio-pajisja të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me rregulloren, do të marr menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për të sjellë radio-pajisjen në konformitet, të tërheq apo të kthej atë, nëse është e përshtatshme. Për më tepër, aty ku radio-pajisja paraqet rrezik, distributorët do të informojnë menjëherë ARKEP-in për këtë qëllim, duke dhënë detaje, në mënyrë të veçantë, për mos-pajtueshmërinë dhe për masat korrigjuese të ndërmarra.

5. Distributorët duhet, pas një kërkesë të arsyetuar nga ARKEP, brenda afatit të përcaktuar nga ARKEP-i të ofrojnë të gjitha informatat dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër apo formë elektronike për të demonstruar konformitetin e radio-pajisjes. Ata do të bashkëpunojnë me ARKEP, sipas kërkesës së tij, mbi çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga radio-pajisjet të cilat ata i kanë vendosur në treg.

Neni 11

Rastet në të cilat obligimet e prodhuesit zbatohen për importuesit dhe distributorët

1. Një importues apo distributor do të konsiderohet si një prodhues për qëllime të Rregullores dhe ai do t'i nënshtrohet obligimeve të prodhuesit sipas nenit 7, ku ai vendos radio-pajisje në treg nën emrin ose markën e tij tregtare ose modifikon radio-pajisjen e vendosur tashmë në treg në atë mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Neni 12

Identifikimi i operatorëve ekonomik

1. Operatorët ekonomik, në bazë të kërkesës, do të identifikojnë informatat në vijim për ARKEP:
 - 1.1. çdo operator ekonomik që i ka furnizuar ata me radio-pajisje;
 - 1.2. çdo operator ekonomik të cilët ata i kanë furnizuar me radio-pajisje
2. Operatorët ekonomik do të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përmendur në paragrafin e parë për 10 vjet, pasi ata janë furnizuar me radio-pajisje dhe për 10 vjet pasi ata kanë furnizuar me radio-pajisje.

KAPITULLI III

KONFORMITETI I RADIO-PAJISJES

Neni 13

Prezumimi i konformitetit të radio-pajisjes

1. Radio-pajisja e cila është në konformitet me standardet e harmonizuara evropiane ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose është në konformitet me standardet e harmonizuara të Kosovës, do të prezumohet që është në konformitet me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5 të mbuluar nga ato standarde ose pjesë të tyre.
2. ARKEP ofron listën e standardeve të harmonizuara evropiane dhe listën e standardeve të harmonizuara të Kosovës të referuar në paragrafin 1 të këtij neni në uebfaqën www.arkep-rks.org.

Neni 14

Procedurat për vlerësimin e konformitetit

1. Prodhuesi do të kryej një vlerësim të konformitetit të radio-pajisjes me qëllim të plotësimit të kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 5. Vlerësimi i konformitetit duhet të merr parasysh të gjitha kushtet operative të synuara dhe kërkesat thelbësore të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 5, vlerësimi duhet të marrë parasysh kushtet e arsyeshme të parapara. Në raste kur radio-pajisja mund të marrë konfigurime të ndryshme, vlerësimi i konformitetit duhet të konfirmoj nëse radio-pajisja plotëson kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5 në të gjitha konfigurimet e mundshme.
2. Prodhuesit duhet të demonstrojnë pajtueshmërinë e radio-pajisjes me kërkesat thelbësore të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 5 duke përdorur ndonjë nga procedurat e mëposhtme të vlerësimit të konformitetit:
 - a) kontrollin e prodhimit të brendshëm të përcaktuar në Shtojcën II;
 - b) Ekzaminimi i tipit që pasohet me konformitetin e tipit në bazë të kontrollit të brendshëm të prodhimit të përcaktuar në Shtojcën III;
 - c) konformiteti në bazë të sigurimit të plotë të cilësisë të përcaktuar në Shtojcën IV.
3. Atëherë kur, gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë së radio-pajisjes me kërkesat thelbësore të përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 5, prodhuesi ka zbatuar standardet e harmonizuara evropiane, referencat e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose standardet korresponduese të harmonizuara të Kosovës, ai do të përdorë ndonjërin prej procedurave të mëposhtme:
 - a) kontrollimin e brendshëm të prodhimit të përcaktuar në Shtojcën II;
 - b) Ekzaminimin i tipit që pasohet me konformitetin e tipit në bazë të kontrollit të brendshëm të prodhimit të përcaktuar në Shtojcën III;
 - c) konformiteti në bazë të sigurimit të plotë të cilësisë të përcaktuar në Shtojcën IV.
4. Atëherë kur, gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë së radio-pajisjes me kërkesat thelbësore të përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 5, prodhuesi nuk ka zbatuar apo ka zbatuar pjesërisht standardet e harmonizuara evropiane, referencat e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose pjesërisht korrespondojnë me standardet e harmonizuara të Kosovës, ose kur standardet e tilla të harmonizuara nuk ekzistojnë, radio-pajisjet duhet të nënshtrohen në lidhje me kërkesat themelore njëres prej procedurave të mëposhtme:
 - a) Ekzaminimin e tipit që pasohet me konformitetin e tipit në bazë të kontrollit të brendshëm të prodhimit të përcaktuar në Shtojcën III;
 - b) konformiteti në bazë të sigurimit të plotë të cilësisë të përcaktuar në Shtojcën IV.

Neni 15

Deklarata e konformitetit

1. Deklarata e konformitetit duhet të theksoj se përmbushja e kërkesave themelore të përcaktuara në nenin 5 është demonstruar.
2. Deklarata e konformitetit duhet të ketë strukturën e modelit të përcaktuar në Shtojcën VI, duhet të përmbajë elementet e përcaktuara në atë Shtojcë dhe duhet të përditësohet vazhdimisht. Ajo duhet të ofrohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Deklarata e thjeshtësuar e konformitetit e referuar në paragrafin 9 të nenit 7 duhet të përmbajë elementet e përcaktuara në Shtojcën VII dhe duhet të përditësohet vazhdimisht. Ajo duhet të ofrohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit duhet të jetë në dispozicion në adresën e internetit, duke iu referuar deklaratës së thjeshtuar të konformitetit, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës ose në gjuhën angleze.
4. Në raste kur radio-pajisja i nënshtrohet më shumë se një akti ligjor që kërkon një deklaratë konformiteti, atëherë duhet të hartohet një deklaratë e vetme e konformitetit në lidhje me të gjitha aktet e tilla ligjore. Kjo deklaratë duhet të përmbajë identifikimin e legjislacionit të harmonizimit Evropian në fjalë duke përfshirë referencat e tyre të publikimit.
5. Përmes hartimit të deklaratës së konformitetit, prodhuesi do të marrë përgjegjësinë për pajtueshmërinë e radio-pajisjes me kërkesat e përcaktuara në Rregullore.

Neni 16

Parimet e përgjithshme të shënjitimit të konformitetit

1. Shënjitimi i konformitetit duhet të jetë subjekt i parimeve dhe rregullave të përgjithshme për formën, përmbajtjen dhe përdorimin e saj, siç është përcaktuar në Rregulloren nr. 06/2013 mbi shenjën e konformitetit.

Neni 17

Kushtet dhe rregullat për vendosjen e shenjës së konformitetit dhe identifikimi i numrit të trupit notifikues

1. Shenja e konformitetit duhet të vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme në radio-pajisjen apo pllakëzën e të dhënave të saj, përveç nëse kjo nuk është e mundur ose nuk garantohej për shkak të natyrës së radio-pajisjes. Shënjitimi i konformitetit duhet të vendoset në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme në paketim.
2. Shenja e konformitetit duhet të vendoset para se radio-pajisja të vendoset në treg.
3. Shënjitimi i konformitetit duhet të pasohet nga numri identifikues i trupit notifikues, ku aplikohet procedura e vlerësimit të konformitetit të përcaktuar në Shtojcën IV. Numri identifikues i trupit notifikues do të ketë të njëjtën lartësi si shenja e konformitetit. Numri identifikues i trupit notifikues, do të vendoset nga vet trupi notifikues, ose sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Neni 18

Dokumentacioni teknik

1. Dokumentacioni teknik duhet të përmbaj të gjitha të dhënat relevante ose detajet e metodave të përdorura nga prodhuesi për të siguruar që radio-pajisja të jetë në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5. Ai duhet, të paktën të përmbaj elementet e përcaktuara në Shtojcën V.
2. Dokumentacioni teknik duhet të hartohet para se radio-pajisja të vendoset në treg dhe duhet të përditësohet vazhdimisht.
3. Dokumentacioni teknik dhe korrespondenca në lidhje me çdo procedurë të ekzaminimit të tipit, do të hartohet në gjuhën zyrtare të Shtetit Anëtar të BE, në të cilën është themeluar trupi notifikues ose në një gjuhë të pranueshme për atë trup, ose në gjuhë të pranueshme për trupin e caktuar për vlerësimin e konformitetit.
4. Atëherë kur dokumentacioni teknik nuk është në përputhje me paragrafët 1, 2 ose 3 të këtij neni, dhe në këtë mënyrë nuk arrin të paraqesë të dhëna të mjaftueshme relevante ose masat e përdorura për të siguruar pajtueshmërinë e radio-pajisjes me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5, ARKEP mund të kërkojë nga prodhuesi ose importuesi që të kryhet një test nga një trup i pranueshëm për ARKEP-in me shpenzime të prodhuesit apo importuesit brenda një periudhë të caktuar kohore për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5.

KAPITULLI IV

AUTORIZIMI I TRUPAVE PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT

Neni 19

Autorizimi

1. Detyrat e vlerësimit të konformitetit sipas Rregullores mund të kryhen nga trupat e caktuara të vlerësimit të konformitetit që i plotësojnë kërkesat e Rregullores dhe janë të autorizuar me vendimin e ARKEP në bazë të Ligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit dhe Udhëzimit Administrativ për Autorizimin e Trupave për Vlerësim të Konformitetit.
2. Një trup për vlerësimin e konformitetit duhet të paraqesë një aplikacion për autorizim tek ARKEP.
3. Aplikimi për autorizim duhet të shoqërohet me një përshkrim të aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit, modulit ose modulet e vlerësimit të konformitetit dhe radio-pajisjes për të cilën trupi pretendon të jetë kompetent, si dhe një certifikatë të akreditimit, të lëshuar nga trupi akreditues i Kosovës që dëshmon se trupi për vlerësimin e konformitetit përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 20.
4. ARKEP shqyrton dokumentacionin duke iu referuar paragrafëve 2 dhe 3 dhe në bazë të këtij ekzaminimi lëshon ose refuzon të lëshojë vendimin që autorizon trupin për vlerësim të konformitetit të kryej detyrat e vlerësimit të konformitetit sipas Rregullores.

5. Vendimi i ARKEP përcakton modulën ose modulet e vlerësimit të konformitetit dhe radio-pajisjen për të cilin trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit është kompetent për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit sipas Rregullores.
6. Vendimet e ARKEP janë valide deri në shfuqizim.
7. Nëse ARKEP konstaton se trupi i caktuar për vlerësimin e konformitetit nuk iu është përmbajtur kërkesave të nenit 20, ARKEP nxjerr vendim që shfuqizon vendimin me të cilin trupi për vlerësimin e konformitetit është i autorizuar ose një vendim ku anulohen aktivitetet e autorizuarat të vlerësimit të konformitetit, moduli ose modulet e vlerësimit të konformitetit dhe radio-pajisja, në të cilën trupi nuk iu është përmbajtur kërkesave të nenit 20.

Neni 20

Kërkesat në lidhje me trupat që aplikojnë për autorizim

1. Për qëllime të autorizimit, trupi për vlerësimin e konformitetit duhet të plotëson kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 deri në 11 të këtij neni.
2. Trupi për vlerësimin e konformitetit regjistrohet në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë dhe ka cilësinë e personit juridik.
3. Trupi për vlerësimin e konformitetit është palë e tretë, trup i pavarur nga organizata apo radio-pajisja që e vlerëson.

Trupi që i përket një shoqate afariste apo profesionale që përfaqëson ndërmarrjet e përfshira në dizajnimin, prodhimin, ofrimin, montimin, përdorimin apo mirëmbajtjen e radio-pajisjeve që i vlerëson, mund të konsiderohet si trup i tillë, me kusht që të demonstroi pavarësinë e tij dhe mungesën e konflikteve të interesit.

4. Trupi për vlerësimin e konformitetit, menaxhmenti i tij i lartë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave për vlerësimin e konformitetit nuk është dizajneri, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi apo mirëmbajtësi i radio-pajisjes që ata e vlerësojnë, e as përfaqësuesi i autorizuar i ndonjëres nga ato palët. Kjo nuk pengon përdorimin e radio-pajisjeve të vlerësuara që janë të nevojshme për operacionet e trupit për vlerësimin e konformitetit apo përdorimin e radio-pajisjeve të tilla për qëllime personale.

Trupi për vlerësimin e konformitetit, menaxhmenti i tij i lartë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave për vlerësimin e konformitetit nuk përfshihen drejtpërdrejtë në dizajnimin, prodhimin dhe ndërtimin, marketingun, instalimin, përdorimin apo mirëmbajtjen e atyre radio-pajisjeve, apo të përfaqësojë palët e angazhuara në ato aktivitete. Ata nuk angazhohen në aktivitete që mund të jetë në kundërshtim me pavarësinë, gjykimin apo integritetin e tyre në lidhje me aktivitetet për vlerësimin e konformitetit për të cilat janë të autorizuar. Kjo nuk vlen për shërbimet e konsulencës.

Trupat për vlerësimin e konformitetit sigurojnë që aktivitetet e filialeve apo nënkontraktorëve të tyre nuk ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin apo paanshmërinë e aktiviteteve të tyre për vlerësimin e konformitetit.

5. Trupat për vlerësimin e konformitetit dhe personeli i tyre kryen aktivitete për vlerësimin e konformitetit me nivelin më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencën teknike të nevojshme në fushën specifike dhe nuk ka presione apo nxitje, veçanërisht financiare, që mund të ndikojnë në gjykimin e tyre apo rezultatet e aktiviteteve të tyre për vlerësimin e konformitetit, veçanërisht në lidhje me personat apo grupet e personave që kanë interes në rezultatet e këtyre aktiviteteve.
6. Trupi për vlerësimin e konformitetit është në gjendje të kryej të gjitha detyrat për vlerësimin e konformitetit të caktuara në bazë të shtojcave III dhe IV në lidhje me të cilat edhe është autorizuar, qoftë nëse këto detyra kryhen nga vetë trupi për vlerësimin e konformitetit apo nën emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

Në çdo kohë dhe për çdo procedurë për vlerësimin e konformitetit dhe çdo lloj apo kategori të radio-pajisjes në lidhje me të cilën është autorizuar, trupi për vlerësimin e konformitetit kanë dispozicion të nevojshëm:

- a) personelin e nevojshëm me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe të duhur për kryerjen e detyrave për vlerësimin e konformitetit;
- b) përshkrimet e nevojshme të procedurave në përputhje me të cilat kryhet vlerësimi i konformitetit, duke siguruar transparencën dhe aftësinë e rigjenerimit të këtyre procedurave. Ka politika dhe procedura të duhura që bëjnë dallimin ndërmjet detyrave që i kryen si trup i caktuar për vlerësimin e konformitetit dhe aktivitetet tjera;
- c) procedurat për kryerjen e aktiviteteve që marrin parasysh madhësinë e një ndërmarrje, sektorin në të cilin operon, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë të radio-pajisjes në fjalë dhe natyrën masive apo serike të procesit të prodhimit.

Trupi për vlerësimin e konformitetit ka mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrave teknike dhe administrative të ndërlidhura me aktivitetet për vlerësimin e konformitetit në mënyrë të duhur.

7. Personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit duhet të posedoj:
 - a) trajnim të duhur teknik dhe profesional që mbulon të gjitha aktivitetet e vlerësimit të konformitetit në lidhje me të cilat është autorizuar trupi për vlerësimin e konformitetit;
 - b) njohuri të kënaqshme mbi kërkesat e vlerësimeve që ata kryejnë dhe autoritetin e duhur për të kryer këto vlerësime;
 - c) Njohuria adekuate dhe të kuptuarit e kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 5, nga standardet e aplikueshme të harmonizuara evropiane apo standardet e harmonizuara të Kosovës dhe të dispozitave të legjislacionit përkatës relevant;
 - d) Aftësinë për të hartuar certifikatat e ekzaminimit të tipit ose miratimet e sistemit të cilësisë, të dhënat dhe raportet që demonstrojnë se vlerësimet janë kryer.

8. Paanshmëria e trupave për vlerësimin e konformitetit, menaxhmentit të nivelit të lartë dhe personelit përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit, duhet të jetë e garantuar.

Kompensimi i menaxhmentit dhe i personelit përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit të një trupi për vlerësimin e konformitetit nuk duhet të varet nga numri i vlerësimeve të kryera ose nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

9. Trupat e vlerësimit të konformitetit do të marrin sigurimin e përgjegjësisë në lidhje me aktivitetet e saj të autorizuara.
10. Personeli i një trupi për vlerësimin e konformitetit duhet të respektoj sekretin profesional lidhur me të gjithë informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas Shtojcave III dhe IV apo ndonjë dispozite të legjislacionit kombëtar që u jep fuqi atyre, përveç në lidhje me autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës. Të drejtat e pronësisë duhet të mbrohen.
11. Trupat e vlerësimit të konformitetit duhet të marrin pjesë, ose të sigurojnë që personeli i tyre përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit të jetë i informuar mbi veprimtaritë përkatëse të standardizimit, aktiviteteve rregullatore në fushën e radio-pajisjeve dhe mbi planifikimin e radio frekuencave.

Neni 21

Prezumimi i konformitetit të trupave të caktuar për vlerësimin e konformitetit

1. Atëherë kur trupi për vlerësimin e konformitetit demonstroi konformitetin e tij me kriteret e përcaktuara në standardet relevante të Kosovës që kanë aprovuar standardet e harmonizuara Evropiane apo pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, prezumohet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 20 të rregullores për aq sa standardet e aplikueshme të harmonizuara Evropiane mbulojnë këto kërkesa.

Neni 22

Filialet dhe nën-kontraktimi nga trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit

1. Atëherë kur trupi i caktuar për vlerësimin e konformitetit nën-kontraktori detyrohet specifikisht në lidhje me vlerësimin e konformitetit apo ka mbështetje nga një filiale, duhet të sigurohet që nën-kontraktori apo filialja plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 20 dhe informon Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.
2. Trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit marrin përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nën-kontraktorët apo filialet, kurdo që këto themelohen.
3. Aktivitetet mund të nën-kontraktohen apo kryhen nga një filial vetëm me pajtimin e klientit.
4. Trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit mbajnë në dispozicion të ARKEP-it dokumentet relevante në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nën-kontraktorit apo filialës dhe punën e kryer nga ata sipas Shtojcave III dhe IV.

Neni 23

Obligimet operative të trupave të caktuar për vlerësimin e konformitetit

1. Trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit kryejnë vlerësime të konformitetit në përputhje me procedurat për vlerësimin e konformitetit të parapara në Shtojcat III dhe IV.
2. Vlerësimet e konformitetit kryhen në mënyrë proporcionale, duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomik. Trupat për vlerësimin e konformitetit kryejnë aktivitetet e tyre duke marrë parasysh madhësinë e një ndërmarrje, sektorin në të cilin operon, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë në fjalë të radio-pajisjes dhe natyrën masive apo serike të procesit të prodhimit.

Duke vepruar në këtë mënyrë, ata duhet të respektojnë shkallën e rigorozitetit dhe nivelin e mbrojtjes së kërkuar për pajtueshmërinë e radio-pajisjeve me rregulloren.

3. Atëherë kur trupi i caktuar për vlerësimin e konformitetit konstaton se kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5 apo standardet përkatëse të harmonizuara Evropiane apo standardet e harmonizuara të Kosovës apo specifikimet tjera teknike nuk janë plotësuar nga prodhuesi, kërkon që prodhuesi të ndërmerr masat e duhura korrigjuese dhe nuk lëshon certifikatën për ekzaminimin e tipit apo aprovimin e sistemit të cilësisë.
4. Atëherë kur në rrjedhën e monitorimit të konformitetit pas lëshimit të certifikatës së ekzaminimit të tipit apo aprovimit të sistemit të cilësisë, trupi i caktuar për vlerësimin e konformitetit konstaton se radio-pajisja nuk është më në përputhje, kërkon nga prodhuesi të ndërmerr masat e duhura korrigjuese dhe pezullon apo tërheq certifikatën për ekzaminimin e tipit apo aprovimin e sistemit të cilësisë, nëse është e nevojshme.
5. Atëherë kur masat korrigjuese nuk ndërmerren apo nuk kanë efektin e kërkuar, trupi i caktuar për vlerësimin e konformitetit sipas nevojës kufizon, pezullon apo tërheqë certifikatat e ekzaminimit të tipit, apo aprovimet e sistemit të cilësisë.

Neni 24

Obligimi për informim i trupave të caktuar për vlerësimin e konformitetit

1. Trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit informojnë ARKEP mbi:
 - a) çdo refuzim, kufizim, suspendim apo tërheqje të certifikatës së ekzaminimit të tipit apo aprovimit të sistemit të cilësisë në përputhje me kërkesat e Shtojcave III dhe IV;
 - b) çdo rrethanë që ndikon në fushëveprimin apo kushtet për autorizim;
 - c) çdo kërkesë për informacione që e kanë pranuar nga ARKEP-i në lidhje me aktivitetet për vlerësimin e konformitetit;
 - d) sipas kërkesës, aktivitetet për vlerësimin e konformitetit të kryera brenda fushëveprimit të autorizimit të tyre dhe çdo aktivitet tjetër i kryer, përfshirë aktivitetet ndërkufitare dhe nën-kontraktimin.

2. Trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me kërkesat e Shtojcave III dhe IV, iu ofrojnë trupave tjerë të autorizuar sipas rregullores, të cilët kryejnë aktivitete të ngjashme për vlerësimin e konformitetit që mbulojnë të njëjtat kategori të radio-pajisjeve informacione relevante mbi çështjet që ndërlidhen me rezultatet negative dhe, sipas kërkesës, rezultatet pozitive të vlerësimit të konformitetit.
3. Trupat e caktuar për vlerësimin e konformitetit përmbushin detyrimet për informim sipas Shtojcave III dhe IV.

KAPITULLI V

MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KONTROLLI I RADIO-PAJISJEVE QË HYJNË NË TREG

Neni 25

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i aparateve që hyjnë në treg

1. ARKEP do të bëjë mbikëqyrjen e tregut dhe kontrollin e radio-pajisjeve që hynë në tregun e Republikës së Kosovës.

Neni 26

Procedura për trajtimin e radio-pajisjeve që paraqesin rrezik

1. Atëherë kur ARKEP-i ka arsye të mjaftueshme për të besuar që radio-pajisja e mbuluar nga rregullorja paraqet rrezik për shëndetin apo sigurinë e personave apo aspektet tjera të mbrojtjes së interesit publik të mbuluar nga rregullorja, kryen një vlerësim në lidhje me radio-pajisjen në fjalë, duke mbuluar të gjitha kërkesat relevante të përcaktuara në rregullore. Operatorët ekonomik relevant bashkëpunojnë sipas nevojës me ARKEP-in për atë qëllim.
2. Atëherë kur gjatë rrjedhës së vlerësimit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, ARKEP-i konstaton se radio-pajisja nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore, kërkon pa vonesë nga operatori relevant ekonomik që të ndërmerr të gjitha veprimet korrigjuese në mënyrë që produkti të plotësojë këto kërkesa, ta tërheqë radio-pajisjen nga tregu, apo ta kthejë atë brenda një periudhe të përcaktuar nga ARKEP, konform natyrës së rrezikut, dhe për këtë ARKEP e informon trupin relevant të përcaktuar për vlerësimin e konformitetit.
3. Neni 23 i Ligjit nr. 04/L-039 mbi kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit zbatohet për masat e referuara në paragrafin 2 të këtij neni.
4. Atëherë kur operatori relevant ekonomik nuk ndërmerr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së referuar në paragrafin 2 të këtij neni, ARKEP-i ndërmerr të gjitha masat e duhura të përkohshme për të ndaluar apo kufizuar radio-pajisjet që janë duke u vënë në dispozicion në treg, për tërheqjen e radio-pajisjeve nga tregu apo kthimin e saj.

Neni 27

Radio-pajisja e cila është në pajtueshmëri por paraqet rrezik

1. Atëherë kur pas kryerjes së një vlerësimi sipas paragrafit 1 të nenit 26 ARKEP-i konstaton se edhe pse radio-pajisja është në përputhje me rregulloren, ajo paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë e personave apo aspekte tjera të mbrojtjes së interesit të publikut të përfshirë në këtë rregullore, kërkon nga operatori përkatës ekonomik që të ndërmerr të gjitha masat e duhura për të siguruar që radio-pajisja në fjalë, kur vendoset në treg, nuk paraqet më rrezik, ta tërheqë radio-pajisjen nga tregu apo ta kthejë atë brenda një periudhe të arsyeshme, në përputhje me natyrën e rrezikut

Neni 28

Mos-pajtueshmëria formale

1. Pa paragjykuar nenin 26, në raste kur ARKEP-i identifikon një nga të gjeturat në vijim, kërkon nga operatori ekonomik që ti jap fund mos-pajtueshmërisë në fjalë brenda periudhës së caktuar të ARKEP-it:
 - a) shenja e konformitetit është vendosur në kundërshtim me nenet 16 dhe 17;
 - b) shenja e konformitetit nuk është vendosur;
 - c) numri identifikues i trupit njoftues, atëherë kur aplikohet procedura e vlerësimit e përcaktuar në Shtojcën IV, është vendosur në kundërshtim me nenin 17 apo nuk është vendosur;
 - d) deklarata e konformitetit nuk është hartuar;
 - e) deklarata e konformitetit nuk është hartuar në mënyrë të saktë;
 - f) dokumentacioni teknik nuk është në dispozicion apo nuk është i plotë;
 - g) informacionet e referuara në paragrafin 6 apo paragrafin 7 të nenit 7 apo paragrafin 3 të nenit 9, mungojnë, i pasaktaapo jo të plota;
 - h) informacionet mbi përdorimin e synuar të radio-pajisjes, deklarata e konformitetit apo kufizimet e përdorimit siç përcaktohen në paragrafët 8, 9 dhe 10 të nenit 7 nuk e shoqërojnë radio-pajisjen;
 - i) kërkesat për identifikimin e operatorëve ekonomik të përcaktuara në nenin 12 nuk janë përmbushur.
2. Atëherë kur mos-pajtueshmëria e referuar në paragrafin 1 të këtij neni vazhdon më gjatë se periudha e caktuar nga ARKEP, ARKEP-i ndërmerr të gjitha masat e duhura për kufizimin apo ndalimin e radio-pajisjes përkatëse që është vënë në treg apo sigurohet se është tërhequr apo kthyer nga tregu.

Neni 29 **Sanksionet**

1. Në rast të moszbatimit të kësaj rregullore, ARKEP do të shqiptojë sanksione ekonomike si në vijim;
 - 1.1 Për operatorin ekonomik, i cili është ndermarres sipas nenit 4 paragrafi 1.11 të Ligjit, do të shqiptohen sanksionet ekonomike sipas këtij Ligji.
 - 1.2 Për operatorin ekonomik, i cili nuk është ofruar i rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike do të shqiptohen sanksionet ekonomike në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

KAPITULLI VI **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

Neni 30 **Informacionet në lidhje me kufizimet dhe radio ndërfaqet**

1. Lista e radio-pajisjeve që mund të vendosen në treg dhe të vendosen në shërbim pa kufizime është ofruar në ueb-faqen e ARKEP-it [www.arkep-rks.org/Lista e Pajisjeve](http://www.arkep-rks.org/Lista_e_Pajisjeve)).
2. Radio ndërfaqet me të cilat korrespondojnë radio-pajisjet përkatëse janë ofruar në Planin Kombëtar të Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të spektrit radio frekuencor të Republikës së Kosovës. Mund të gjendet në ueb-faqen e ARKEP-it www.arkep-rks.org).

Neni 31 **Shfuqizimi**

1. Rregullores Teknike për Radio Pajisje dhe Pajisje Terminale Telekomunikuese dhe Kompatibilitetin Elektromagnetik - njohja e konformitetit (Nr.Prot. 025/B/13) dhe Vendimi Nr. 380 (Nr.Prot 024/B/13) për Klasën 1 të radio pajisjeve shfuqizohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.

Neni 32 **Dispozitat kalimtare**

1. Radio-pajisja e përfshirë me këtë Rregullore që është në konformitet me legjislacionin e aplikueshëm relevant para datës 31 Dhjetor 2017 dhe të cilat janë vendosur në treg para kësaj date, mund të vihet në dispozicion në treg apo të vendoset në shërbim.

Neni 33 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hynë në fuqi me 31 Dhjetor 2017.

Prishtinë, 27 Prill, 2017

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit**

SHTOJCA I PRODUKTET, PJESËT DHE PAJISJET AJRORE

Produktet, pjesët dhe pajisjet ajrore që konsiderohen që janë **jashtë fushëveprimit** të kësaj rregullore janë:

avion, motor, helikë ose ndonjë instrument, pajisje, mekanizëm, pjesë, aparat, artikull apo aksesorë, përfshirë pajisjet e komunikimit që përdoren apo synohen të përdoren në operimin apo kontrollin e avionit gjatë fluturimit dhe instalohet apo i bashkëngjitet avionit, përveç:

Pajisjet e brendshme që bien brenda përkufizimit të nën-paragrafit 1.1 të nenit 4 të rregullores dhe nuk përdoren apo synohen të mos përdoren në operimin apo kontrollin e një avioni gjatë fluturimit.

Avionët pa pilot me masën operuese jo më të madhe se 150 kg dhe pjesët dhe pajisjet e tyre që bien nën përkufizimin e nën-paragrafit 1.1 të nenit 4 të Rregullores.

SHTOJCA II

MODULI A: KONTROLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

1. Kontrolli i brendshëm i prodhimit është procedura për vlerësimin e konformitetit nëpërmjet së cilës prodhuesi përmbushë obligimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të kësaj shtojce dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi se radio-pajisja në fjalë përmbushë kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5 të rregullores.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të harton dokumentacionin teknik në përputhje me nenin 18.

3. Prodhimi

Prodhuesi ndërmerr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë pajtueshmërinë e radio-pajisjes së prodhuar me dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2 të kësaj shtojce dhe me kërkesat relevante thelbësore të përcaktuara në nenin 5.

4. Shenja e konformitetit dhe deklarata e konformitetit

4.1. Prodhuesi vendos shenjën e konformitetit në përputhje me nenet 16 dhe 17 në secilin artikull të radio-pajisjes që përmbushë kërkesat e aplikueshme të rregullores.

4.2. Prodhuesi harton deklaratën me shkrim të konformitetit për çdo lloj të radio-pajisjes dhe e mban atë së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vite pas vendosjes së radio-pajisjes në treg. Deklarata e konformitetit identifikon radio-pajisjen për të cilën është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit vihet në dispozicion të ARKEP, sipas kërkesës.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Obligimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij apo nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato janë të specifikuara në mandat.

SHTOJCA III
MODULET B DHE C: EKZAMINIMI I TIPIT DHE KONFORMITETIT TË TIPIT
BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT

Atëherë kur bëhet referimi në këtë shtojcë, procedura për vlerësimin e konformitetit ndjek Modulet B (ekzaminimi i tipit) dhe C (konformitetit të tipit bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit) të kësaj shtojce.

Moduli B Ekzaminimi i tipit

1. Ekzaminimi i tipit është pjesë e procedurës për vlerësimin e konformitetit në të cilën një trup notifikues apo trup i caktuar për vlerësimin e konformitetit ekzaminon dizajnin teknik të radio-pajisjes dhe verifikon dhe ateston nëse dizajni teknik i radio-pajisjes plotëson kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 5.

2. Ekzaminimi i tipit kryhet me vlerësim të mjaftueshëm të dizajnit teknik të radio-pajisjes nëpërmjet ekzaminimit të dokumentacionit teknik dhe dëshmisë mbështetëse të referuar në pikën 3, pa ekzaminimin e mostrës (tipi i dizajnit).

3. Prodhuesi duhet të paraqet një aplikacion për ekzaminimin e tipit tek një trup i vetëm notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit. Aplikacioni duhet të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikacioni paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij;

(b) deklaratën me shkrim që aplikacioni i njëjtë nuk është paraqitur tek ndonjë trup tjetër notifikues apo trup i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit;

(c) **dokumentacionin teknik**- Dokumentacioni teknik mundëson vlerësimin e konformitetit të radio-pajisjes me kërkesat e aplikueshme të kësaj rregullore dhe përfshin një analizë dhe vlerësim të duhur të rrezikut/rreziqeve. Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e aplikueshme dhe mbulon për aq sa është relevante për vlerësimin, dizajnimin, prodhimin dhe operimin e radio-pajisjes. Dokumentacioni teknik përmban, kurdo që është e aplikueshme, elementet e përcaktuara në Shtojcën V;

(d) dëshmia mbështetëse për zgjedhjen adekuate të dizajnit teknik. Kjo dëshmi mbështetëse do të përfshijë dokumentet që janë përdorur, në veçanti ku standardet relevante të harmonizuara Evropiane apo standardet e harmonizuara Kosovare nuk janë aplikuar apo nuk janë aplikuar plotësisht. Dëshmia mbështetëse do të përfshijë, atëherë kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet tjera relevante teknike nga laboratorit përkatës i prodhuesit, apo nga ndonjë laborator tjetër testues në emër të tij apo nën përgjegjësinë e tij.

4. Trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit ekzaminon dokumentacionin teknik dhe dëshminë mbështetëse për të vlerësuar dizajnin adekuat teknik të radio-pajisjes.

5. Trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit nxjerr raportin e vlerësimit që evidenton aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 4 dhe rezultatet e tyre. Pa paragjykuar në obligimet e parapara në pikën 8, trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit nxjerr përmbajtjen e atij raporti, plotësisht apo pjesërisht, vetëm në marrëveshje me prodhuesin.

6. Atëherë kur tipi plotëson kërkesat e kësaj rregullore që zbatohen për radio-pajisjet në fjalë, trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit i lëshon prodhuesit certifikatën për ekzaminimin e tipit. Ajo certifikatë përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e ekzaminimit, aspektet e kërkesave thelbësore të mbuluara nga ekzaminimi, kushtet (nëse ka) për validitetin e saj dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të vlerësuar. Certifikata e ekzaminimit të tipit mund të ketë një ose me shumë shtojca të bashkangjitura. Certifikata e ekzaminimit të tipit dhe shtojcat e saj përmbajnë të gjitha informacionet relevante për të mundësuar konformitetin e radio-pajisjeve të prodhuara me tipin e ekzaminuar që duhet të vlerësohet dhe për të mundësuar kontrollin në shërbim. Atëherë kur tipi nuk përmbushë kërkesat e aplikueshme të kësaj rregullore, trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit refuzon të lëshojë certifikatën e ekzaminimit të tipit dhe informon aplikuesin, duke dhënë arsye të detajuara për refuzimin e saj.

7. Trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit duhet të njoftohet për çdo ndryshim nga gjendjen e fundit e përgjithëshme e pranuar, e cila tregon që tipi i aprovuar mund të mos përmbushë më tej kërkesat e aplikueshme të kësaj rregullore dhe përcakton nëse nevojitet hetim i mëtejshëm për ndryshimet e tilla. Nëse po, trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit informon prodhuesin.

Prodhuesi informon trupin notifikues apo trupin e përcaktuar për vlerësimin e konformitetit që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën e ekzaminimit të tipit dhe të gjitha modifikimeve në tipin e aprovuar që mund të ndikojnë në konformitetin e radio-pajisjeve me kërkesat thelbësore të kësaj rregullore apo kushtet për validitetin e asaj certifikate. Modifikimet e tilla kërkojnë miratimin shtesë në formën e një shtese në certifikatën origjinale për ekzaminimin e tipit.

8. Çdo trup notifikues apo trup i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit informon autoritetin e tij notifikues apo autoritetin e tij autorizues në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit dhe/ose shtesat në to që i ka lëshuar apo tërhequr dhe do të vënë dispozicion, në baza periodike apo sipas kërkesës, të autoritetit të tij notifikues apo autoritetit autorizues, listën e certifikatave të tilla dhe/ose shtesave të refuzuara, pezulluara apo të kufizuara.

Çdo trup notifikues apo trup i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit informon trupat tjerë notifikues apo autoritetet e autorizuar në lidhje me certifikatat për ekzaminimin e tipi dhe/ose shtesat në to që i ka refuzuar, tërhequr, pezulluar apo kufizuar dhe sipas kërkesës, në lidhje me certifikatat e tilla dhe/ose shtesat të cilat i ka lëshuar.

ARKEP apo trupat tjerë notifikues apo trupat e autorizuar mund, sipas kërkesës, të marrin një kopje të certifikatave për ekzaminimin e tipit dhe/ose shtesave në to.

Sipas kërkesës, ARKEP mund të marrë dokumentacionin teknik dhe rezultatet e ekzaminimeve të kryera nga trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit.

Trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit mbajnë një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit, shtojcat dhe shtesat e saj, si dhe dosjen teknike përfshirë dokumentacionin e dërguar nga prodhuesi për 10 vite pasi që radio-pajisja është vlerësuar apo deri në skadimin e validitetit të asaj certifikate.

9. Prodhuesi mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit, shtojcave dhe shtesave të saj, së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion për ARKEP-in për 10 vite pas vendosjes së radio-pajisjes në treg.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqes aplikacionin e referuar në pikën 3 dhe të përmbushë obligimet e përcaktuara në pikat 7 dhe 9, me kusht që janë specifikuar në mandat.

Moduli C: Konformiteti i tipit bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit

1. Konformiteti i tipit bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesë e procedurës për vlerësimin e konformitetit nëpërmjet së cilës prodhuesi përmbush obligimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 si dhe siguron dhe deklaron që radio-pajisja në fjalë është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit dhe përmbush kërkesat e kësaj rregullore.

2. Prodhimi

Prodhuesi ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e radio-pajisjes së prodhuar me tipin e aprovuar të përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit dhe me kërkesat e kësaj rregullore.

3. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit

3.1. Prodhuesi vendos shenjën e konformitetit në përputhje me nenet 16 dhe 17 në secilin artikull të radio-pajisjes që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit dhe përmbush kërkesat e aplikueshme të kësaj rregullore.

3.2. Prodhuesi harton një deklaratë me shkrim të konformitetit për çdo lloj të radio-pajisjes dhe e mban në dispozicion të ARKEP për 10 vite pasi që radio-pajisja është vendosur në treg.

Deklarata e konformitetit identifikon llojin e radio-pajisjes për të cilën është hartuar. Një kopje e deklaratës së konformitetit vihet në dispozicion të ARKEP, sipas kërkesës.

4. Përfaqësuesi i autorizuar

Obligimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 3 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kushtet që janë të specifikuara në autorizim.

SHTOJCA IV
MODULI H: KONFORMITETI BAZUAR NË SIGURIMIN E PLOTË TË CILËSISË

1. Konformiteti bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë është procedura për vlerësimin e konformitetit nëpërmjet së cilës prodhuesi përmbush obligimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5 si dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësin e tij se radio-pajisjet në fjalë përmbushin kërkesat e kësaj rregullore.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të operojnë një sistem të aprovuar të cilësisë për dizajnimin, prodhimin, inspektimin final të radio-pajisjeve dhe testimin e radio-pajisjeve në fjalë, siç specifikohet në pikën 3 dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes, siç specifikohet në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet aplikacionin për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë tek trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformiteti sipas zgjedhjes së tij, për radio-pajisjen në fjalë.

Aplikacioni përfshin:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikacioni paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;

(b) dokumentacionin teknik për çdo lloj të radio-pajisjes që synohet të prodhohet. Dokumentacioni teknik përmban, kurdo që është e aplikueshme, elementet e përcaktuara në Shtojcën V;

(c) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë; dhe

(d) deklaratën me shkrim që i njëjti aplikacion nuk është paraqitur tek ndonjë trup tjetër notifikues apo trup i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë pajtueshmërinë e radio-pajisjeve me kërkesat e kësaj rregullore.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë lejon një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave të cilësisë.

Në veçanti duhet të përmbajë përshkrimin e:

(a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjëseve dhe kompetencave të menaxhmentit në lidhje me dizajnin dhe cilësinë e produktit;

(b) specifikimeve të dizajnit teknik, përfshirë standardet, që do të aplikohen dhe kur standardet relevante të harmonizuara Evropiane apo standardet e harmonizuara Kosovare nuk do të aplikohen plotësisht, mjetet që do të përdoren për të siguruar që kërkesat thelbësorë të kësaj rregullore që vlejné për radio-pajisjet janë plotësuar;

(c) teknikave, proceseve dhe veprimeve sistematike për kontrollin e dizajnit dhe verifikimin e dizajnit që do të përdoren gjatë dizajnit të radio-pajisjeve që i përkasin tipit të radio-pajisjes të mbuluar;

- (d) teknikave, proceseve dhe veprimeve sistematike përkatëse të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë që do të përdoren;
- (e) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit dhe shpeshësia në të cilën do të përdoren;
- (f) të dhënave mbi cilësinë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet në lidhje me kualifikimet e personelit, etj;
- (g) mjeteve të monitorimit të arritjes së cilësisë së kërkuar të dizajnit dhe produktit dhe operimin efikas të sistemit të cilësisë.

3.3. Trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i përmbush kërkesat e referuara në pikën 3.2. Prezumon konformitetin me kërkesat në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në përputhje me specifikacionet përkatëse të standardit relevant të harmonizuar evropian apo standardit të harmonizuar të Kosovës.

Përveç përvojës në sistemet për menaxhimin e cilësisë, ekipi i auditimit duhet së paku të ketë një anëtar me përvojë si një vlerësues në fushën përkatëse të radio-pajisjes dhe teknologjisë si dhe njohuritë mbi kërkesat e aplikueshme të kësaj rregullore. Auditimi përfshin një vizitë vlerësuese në objektet e prodhuesit. Ekipi auditues shqyrton dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1(b) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat e aplikueshme të kësaj rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë së radio-pajisjes me ato kërkesa.

Prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të njoftohet për vendimin. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi duhet të përmbushë obligimet që dalin nga sistemi i cilësisë siç janë aprovuar dhe ta mirëmbajë ato, në mënyrë që të mbetet adekuat dhe efikas.

3.5. Prodhuesi duhet të mban të informuar trupin notifikues apo trupin e përcaktuar për vlerësimin e konformitetit që ka aprovuar sistemin e cilësisë si dhe ta informoj për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Trupi njoftues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit duhet të vlerësojë çdo ndryshim të propozuara dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 apo nëse është i nevojshëm ri-vlerësimi. Prodhuesi duhet të njoftohet për këtë vendim. Njoftimi duhet të përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit notifikues apo trupit të përcaktuar për vlerësimin e konformitetit

4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është që të sigurohet që prodhuesi përmbushë në mënyrë të duhur obligimet që dalin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet të lejon trupin notifikues apo trupin të përcaktuar për vlerësimin e konformitetit qasje në vendet e dizajnit, prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit dhe duhet të ofroj të gjitha informacionet e nevojshme, në veçanti:

- (a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

(b) të dhënat e cilësisë të cilat ofrohen nga pjesa e dizajnit të sistemit të cilësisë, siç janë rezultatet e analizave, llogaritjeve, testeve, etj.;

(c) të dhënat e cilësisë të cilat ofrohen nga pjesa e prodhimit të sistemit të cilësisë, siç janë raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet në lidhje me kualifikimet e personelit, etj.

4.3. Trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit duhet të kryen auditime periodike për të siguruar që prodhuesi miremban dhe aplikon sistemin e cilësisë dhe duhet ti ofrojë prodhuesit raportin e auditimit.

4.4. Përveç kësaj, trupi notifikues apo trupi për vlerësimin e konformitetit mund të bëjë vizita të papritura tek prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla, trupi notifikues apo trupi për vlerësimin e konformitetit mund, nëse është e nevojshme, të kryej testime të radio-pajisjeve, ose t'i lë që kjo të kryhet nga ata, për të kontrolluar funksionimin e duhur të sistemit të cilësisë. Ai i ofron prodhuesit raportin mbi vizitën dhe nëse është kryer testimi, raportin mbi testimin.

5. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit

5.1. Prodhuesi duhet të vendos shenjë të konformitetit në përputhje me nenet 16 dhe 17, dhe nën përgjegjësinë e trupit notifikues të referuar në pikën 3.1, numrin identifikues të këtij të fundit për secilin artikull të radio-pajisjes që përmbush kërkesat e aplikueshme të përcaktuara në nenin 5.

5.2. Prodhuesi duhet të hartojë deklaratën me shkrim të konformitetit për çdo lloj të radio-pajisjeve dhe duhet të mban në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vite pas vendosjes së radio-pajisjes në treg.

Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë llojin e radio-pajisjes për të cilën është hartuar. Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së vihet në dispozicion të ARKEP-it sipas kërkesës.

6. Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të ARKEP-it deri në 10 vite pasi që radio-pajisja është vendosur në treg:

(a) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1;

(b) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë të referuar në pikën 3.1;

(c) ndryshimin e referuar në pikën 3.5, siç është aprovuar;

(d) vendimet dhe raportet e trupit notifikues apo trupit të përcaktuar për vlerësimin e konformitetit të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo trup notifikues apo trup i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit duhet të informojë autoritetin e tij njoftues apo autoritetin e tij autorizues për aprovimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo tërhequra dhe vë në dispozicion në baza periodike apo sipas kërkesës tek autoriteti i tij notifikues apo autoriteti i tij autorizues listën e aprovimeve të sistemit të cilësisë të refuzuara, pezulluara apo të kufizuara.

Çdo trup notifikues apo trup i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit duhet të informojë trupat e tjerë notifikues dhe trupat e përcaktuar për vlerësimin e konformitetit për aprovimet e sistemit të cilësisë që i ka refuzuar, pezulluar apo tërhequr dhe sipas kërkesës, aprovimevet e sistemit të cilësisë të lëshuara.

8. Përfaqësuesit e autorizuar

Obligimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të plotësohen nga përfaqësuesi i tij nën emrin e tij apo nën përgjegjësinë e tij, me kusht që të specifikohen në autorizim.

SHTOJCA V PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIK

Kur është e aplikueshme, dokumentacioni teknik duhet të përmbajë së paku elementet në vijim:

- (a) përshkrimin e përgjithshëm të radio-pajisjes, duke përfshirë:
 - (i) fotografitë apo ilustrimet që paraqesin veçoritë e jashtme, shënjimin dhe strukturën e brendshme;
 - (ii) versionet e softuerëve dhe firmuerëve që ndikojnë në pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore;
 - (iii) informacionet për përdoruesit dhe udhëzimet për instalim;
- (b) dizajnin konceptual dhe vizatimet e prodhimit dhe skemat e komponentëve, nën-montimeve, qarqeve dhe elementeve tjera të ngjashme përkatëse;
- (c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për kuptimin e atyre vizatimeve dhe skemave dhe operimin e radio-pajisjeve;
- (d) listën e standardeve të harmonizuara Evropiane të zbatuara plotësisht apo pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian apo standardeve relevante të harmonizuara të Kosovës të zbatuara plotësisht apo pjesërisht, dhe kur këto standarde të harmonizuara Evropiane apo standarde të harmonizuara Kosovare nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të adaptuara për plotësimin e kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 5, përfshirë një listë të specifikimeve tjera relevante teknike të aplikuara.
Në rast se standardet e harmonizuara Evropiane apo standardet e harmonizuara të Kosovës janë zbatuara pjesërisht, dokumentacioni teknik duhet të specifikojë pjesët që janë zbatuar;
- (e) kopjen e deklaratës së konformitetit;
- (f) atëherë kur është zbatuar moduli për vlerësimin e konformitetit në Shtojcën III, kopjen e certifikatës së ekzaminimit të tipit dhe shtojcat e saj siç jepen nga trupi notifikues apo trupi i autorizuar
- (g) rezultatet e kalkulimeve të dizajnit të bërë, ekzaminimet e kryera dhe elementet tjera relevante të ngjashme;
- (h) raportet e testit;
- (i) shpjegimi i pajtueshmërisë me kërkesën e paragrafit 2 të nenit 7 dhe të përfshirjes apo jo të informacioneve në përputhje me paragrafin 10 të nenit 7.

SHTOJCA VI
DEKLARATA E KONFORMITETIT (Nr XXX)¹

1. Radio-pajisja (produkti, lloji, numri i serisë apo numri serik):
2. Emri dhe adresa e prodhuesit apo përfaqësuesit të tij të autorizuar:
3. Kjo deklaratë e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.
4. Objekti i deklaramit (identifikimi i radio-pajisjes që lejon gjurmimin; mund të përfshijë një imazh me ngjyra me qartësi të mjaftueshme kur është e nevojshme për identifikimin e radio-pajisjeve):
5. Objekti i deklaramit i përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin e harmonizuar Evropian :

Direktiva 2014/53/EU

Legjislacioni tjetër i harmonizuar Evropian , kur është i aplikueshme

6. Referencat në standardet përkatëse të harmonizuara Evropiane apo standardet e harmonizuara të Kosovës të përdorura apo referencat në specifikimet tjera teknike në lidhje me të cilat konformiteti është deklaruar. Referencat duhet të listohen me numrin e tyre identifikues dhe versionin dhe kur është e aplikueshme, datën e lëshimit:

7. Atëherë kur është e aplikueshme, trupi notifikues apo trupi i përcaktuar për vlerësimin e konformitetit ... (emri, numri) ... kryer ... (përshkrimi i intervenimit) ... dhe ka lëshuar certifikatën për ekzaminimin e tipit: ...

8. Atëherë kur është e aplikueshme, përshkrimi i aksesorëve dhe komponentëve, përfshirë softuerin, i cili i mundëson radio-pajisjes të operoj siç është synuar dhe të përfshihet në deklaratën e konformitetit:

9. Informacionet shtesë:

Nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (nënshkrimi):

¹ Është opsionale për prodhuesin që të caktojë një numër në deklaratën e konformitetit të e BE-së.

SHTOJCA VII
DEKLARATA E THJESHTËSUAR E KONFORMITETIT

Deklarata e thjeshtësuar e konformitetit e referuar në paragrafin 9 të nenit 7 jepet si në vijim:

Përmes kësaj, [Emri i prodhuesit] deklaron që lloji i radio-pajisjes [përcaktimi i llojit të radio-pajisjes] është në përputhje me Direktivën 2014/53/EU. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit është në dispozicion në adresën në vijim në internet: